



Pranuar / Dorezuar Primitenja/Prodato Received/Delivery	19.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5502/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.690/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 690/2022 të datës 05.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 19.09.2022, me shumicë votave mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.690/2022 e datës 05.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 05.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4545/2022 nën shenjë A.nr. 690/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 4225/22 të datës 27.07.2022 dhe Vendimit me numër protokolli 4272/222 të datës 29.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave materiale dhe dispozitave procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli më datë 10.08.2022 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4545/2022 të datës 05.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 4225/22 të datës 27.07.2022 dhe Vendimin me numër protokollit 4272/222 të datës 29.07.2022 i Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendimin me Nr. 08-V-005 të datës 22.03.2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit të datës 01.02.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 05.01.2016, 10.01.2017, 12.02.2018, 31.12.2018, 31.12.2020; Shkresë me numër protokollit 4708 e datës 23.06.2022 nga ankuesi; Shkresën me numër protokollit 4833 të datës 29.06.2022 nga ankuesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 10.08.2022; Konkursin për Drejtor të Njesisë për Auditim të Brendshëm i datës 13.11.2010; Përshkrimin i detyrave të punës për Udhëheqës të Divizionit të Auditimit të Brendshëm; Akt Emërimit e datës 09.02.2014 të nëpunësit Vendimin me numër protokollit 7466 të datës 01.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështje juridike, kontestoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar,*
sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshilli ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar me datë 14.01.2015 është emëruar Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Infrastrukturës. Me tej, nga provat e lëndës rezulton se Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 12.05.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 2674/2022 me të cilin i emëruar sipas Akt emërimit *Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm* në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, caktohet zyrtar përgjegjës për menaxhimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Tujtë Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 27.07.2022 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 4225/22 përmes të cilit Divizioni i Auditimit të Brendshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Divizioni Auditimit të Brendshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor krijohen si njësi e përbashkët si Divizioni i Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa sipas Vendimit me numër protokollit 4272/222 të datës 29.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është bërë shfuqizimi i Vendimit me numër protokollit 2674/2022 të datës 12.05.2022 dhe në të njëjtën kohë si Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës caktohet

Ankuesi në ankesën e tij të ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës pretendon së me Vendimin me numër protokollit 4225/22 të datës 27.07.2022 dhe Vendimin me numër protokollit 4272/222 të datës 29.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është cenuar direkt aktiviteti dhe funksionaliteti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës dhe së i njëjti përbën shkelje flagrante të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Rregullores Nr.16/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në Ministrinë e Infrastrukturës, Rregullores Nr.05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në MPH, si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 10 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, më të cilin është përcaktuar se: ...2. *Ministri (në vijim: ministri përgjegjës) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e sistemit ministror dhe mbikëqyr veprimtarinë e agjencive në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, në pajtim me këtë ligj.* 3. *Funksionimi i sistemit të përgjegjësisë të ministrit për performancën e sistemit ministror përcaktohet në pajtim me legjislacionin për funksionimin e Qeverisë, ndërlidhur me këtë Rregullorja (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive përkatësisht neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ka paraparë se : 1. *Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri:...* 1.5 *Kryen detyra të tjera në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi...**

Bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe nenin 21 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Njësia e Auditimit të Brendshëm përcaktohet si njësi e veçantë administrative me pavarësi funksionale të veprimit, e cila i raporton ministrit si *Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik* ashtu siç përcaktohet me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.15 pika 1.15.4 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ku thuhet se: 15. *Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik - nënkupton individin që mban pozitën më të lartë në hierarki në një subjekt publik, përgjegjës për arritjen e objektivave të organizatës, si vijon:...* 1.15.4. *Ministri përkatës për Ministrinë; rrjedhimisht bazuar në këto dispozita ligjore dhe meqenëse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ende nuk e ka të përfunduar procesin e ristrukturimit pas bashkimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Infrastrukturës, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit vendimet e kundërshtuara me ankesa janë nxjerr në funksion të koordinimit të aktiviteteve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm pranë kësaj ministrie dhe si të tillë këto vendime ka efekt juridik të përkohshëm gjegjësisht deri në miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës respektivisht këto vendime nuk kanë të bëjë me procesin e sistemimit të stafit në rast të riorganizimit lidhur me të cilin proces zbatohet rregullimi ligjore sipas dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji i Këshillit në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në këtë kuptim si dhe referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me Vendimin me numër protokolli 4225/22 i datës 27.07.2022 dhe Vendimin me numër

protokolli 4272/222 i datës 29.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.690/2022 e datës 05.08.2022, e parashtuar nga ankuesi është e papranueshme.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura nga palët në procedurë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me shumicë votash vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi, ndërsa mendimin mospajtues i njërit prej anëtarëve të Kolegjit do t'i bashkëngjitet kësaj lëndë siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 1 të Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.690/2022

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,

